



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 129, Datë 25.06.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 17, DATË 06.02.2024 “MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SH.P.K. PËR MARRJEN E
AUTORIZIMIT TË ERE-S PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI KOLATERAL
PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 54/11 prot., datë 21.06.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 17, datë 06.02.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si kolateral për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 17, datë 06.02.2024, ka vendosur dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. si mjet (kolateral) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve të saj për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palës kredithënëse (Banka e Parë e Investimeve - Albania sh.a. dhe First Investment Bank AD, Sofie Bullgari).
- Në pikën 3 të këtij vendimi i është lënë kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrimit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.
- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë në lidhje me plotësimin e këtij kushti, rezulton se ajo ka depozituar në ERE dokumentacion përkatës ndaj vlerësohet që kjo pikë e vendimit të shfuqizohet.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me

nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 17/2024 shfuqizohet.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI